

AKTI I THEMELIMIT TË SHOQËRISË

“Multi Tasking Studio”

Greta Disha, atësia Haki, e datëlindjes 03.05.1989, e lindur në Krastë, Mat dhe banuese në rruga “Islam Alla”, Nd. 34, H.4, Ap.3, Njësia Bashkiake Nr.10, Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, e identifikuar nga pasaporta me nr. I95503065B, me nr.telefoni 0684017770.

Në datë 27.12.2023, mbështetur në Ligjin Nr.9901 dt. 14/04/2008, “Për shoqëritë Tregtare” dhe në Legjislacionin shqiptar në përgjithësi, kanë vendosur si më poshtë:

Emërtimi, Selia dhe afati i Shoqërisë

Neni 1

Të themelohë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar, për të zhvilluar veprimtari private. Shoqëria është person juridik Shqiptar, veprimtaria e të cilës rregullohet nga kjo kontratë, Statuti i saj dhe Legjislacioni në fuqi.

Neni2

Shoqëria do të emërtohet “Multi Tasking Studio”

Neni 3

Selia e Shoqërisë “**Multi Tasking Studio**”: do të jetë në Tiranë, në adresën: Rruga “Shyqyri Bërxolli”, Nd. Inter CO-SAT, Kati 2, Shkalla 2, Apartamenti 4, Njesia Administrative nr. 7.

Shoqëria mund të vendosë të hapë degë, filiale apo zyra përfaqësie në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë saj.

Neni 4

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj, sipas objektit, për një periudhë të pacaktuar, e cila fillon nga data e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar.

Shoqëria “Multi Tasking Studio”, gëzon statusin e personit juridik shqiptar nga momenti i regjistrimit si e tillë në regjistrin e QKB-së.



Neni 5

Objekti i aktivitetit të shoqërisë “Multi Tasking Studio” do të jetë:

- Prodhim dhe shitje tekstilësh;
- Prodhim dhe shitje materialesh didaktike;
- Prodhim shitje mobiljesh;
- Prodhim shitje materiale elektrike;
- Shitje materiale ndërtimi;
- Shërbime Real Estate;
- Shitblerje automjetesh;
- Qiradhënie automjetesh;
- Shitblerje bizhu, kozmetike.

Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë çdo lloj veprimtarie apo transaksioni tjetër për arritjen dhe plotësimin e objektivit të Shoqërisë, që nuk ndryshon aktivitetin parësor të Shoqërisë dhe nuk bie në kundërshtim me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni 6

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj mbi bazë dege në qytete të tjera të vendit, të cilat do të hapen pasi të ketë filluar aktiviteti i shoqërisë.

Neni 7

Selia e shoqërisë mund të transferohet.

Neni 8

Kur shoqëria pushon veprimtarinë e saj, pasi shlyhen të gjitha detyrimet që ka, pjesën e mbetur të kapitalit dhe të të ardhurave i përfitojnë ortakët e saj.


Ortakët themelues përballojnë humbjet e shoqërisë deri në kufirin e vlerës së tij të derdhur në formimin e kapitalit themeltar. Kapitali baze mund të rritet nga fitimi në natyrë, ose kredi në lekë ose valutë që merret në Bankat e Shtetit Shqiptarë. Kapitali Themeltar për vazhdimin e aktivitetit të shoqërisë është në shumën 100 (njëqind) lekë, që i takon ortakut themelues.

Kapitali themeltar është i ndarë në 1 (një) kuotë.

- Greta Disha me 100% të kapitalit themeltar, 1 (një) Kuotë.

Ortakët, pas zbrithjes së taksave, do t'i ndahen si vijon:

- Fondi rezervë;
- Shpërblymi që u takon ortakëve themelues në masën 100%;



Neni 9

Shoqëria mund të hyjë në veprimtari të përbashkëta me shoqëri të tjera shqiptare ose të huaja.

Neni 10

Veprimtaria e shoqërisë mund të ushtrohet duke krijuar filial ose përfaqësi brenda dhe jashtë vendit, në përputhje me ligjin shqiptar ose të huaj.

Të drejtat dhe detyrimet e Ortakëve


Ortakët gëzojnë këto të drejta kryesore

Neni 11

- Administrimin e veprimtarisë në përputhje me kontratën dhe statutin.
- Pjesëmarrjen në rezultatet e çdo forme dhe sasi të veprimtarisë së shoqërisë e parashikuar në kontratën dhe statutin e saj.
- Paraqitjen e propozimeve dhe shqyrtimin e tyre nga mbledhja e përgjithshme e Asamblesë dhe organet e tjera të shoqërisë.
- Të heqë dorë nga shoqëria, heqja dorë nga shoqëria nuk i liron ortakët nga detyrimet financiare të marra më parë ndaj shoqërisë.
- Të marrë pjesë në organet e shoqërisë që janë ose mund të krijohen nëpërmjet përfaqësuesit të tij ose vetë.
- Të emërojnë dhe të shkarkojë përfaqësuesit e saj, punonjësit, ekspertin kontabël dhe likuidatorët.

Ortakët kanë këto detyrime kryesore:

- Të depozitojnë kuotën e tyre dhe kuotën suplementare në përputhje me kontratën dhe statutin.
- Të marrë pjesë në administrimin e shoqërisë nëpërmjet organeve të krijuara nga vetë ata.
- T'i japë shoqërisë të dhënat e domosdoshme për përpunimin e çdo objekti të veçantë lidhur me veprimtarinë e saj.
- Të kryejë detyrat për realizimin e objektivave dhe të funksioneve të shoqërisë.
- Ka detyrimin nëse heqin dorë nga shoqëria t'i njoftojnë vendimin e tij asamblesë 6 muaj përpara dhe duke ceduuar të drejtën e zgjedhjes sipas nenit.
- T'i japi shoqërisë informatat e nevojshme, që kanë të bëjnë me ecurinë e veprimtarisë së saj.



- Të kryejë shërbimet e nevojshme për arritjen e objektivave të shoqërisë dhe realizimin e funksioneve të saj.

Administrimi

Organi vendimor i shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme.

Neni 12

ADMINISTRATORI

Veprimtaria operative e shoqërisë drejtohet nga administratori. Në Shoqërinë “Multi Tasking Studio”, administrator i shoqërisë do të jetë Greta Disha, atësia Haki, e datëlindjes 03.05.1989, e lindur në Krashtë, Mat dhe banuese në rruga “Islam Alla”, Nd. 34, H.4, Ap.3, Njësia Bashkiake Nr.10, Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, e identifikuar nga pasaporta me nr. I95503065B, e cila në të njëjtën kohë ka dhe funksionin e përfaqësimit të shoqërisë me të tretët në gjithë veprimtarinë e saj. Me miratimin e ortakëve mund të emërohen administratorë dhe përfaqësues të shoqërisë.

Administratori emërohet për një periudhë pesëvjeçare. Administratori ka të gjitha kompetencat për të kryer të gjitha veprimet me interes të shoqërisë dhe në emër të saj nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e veprimtarisë së shoqërisë, me përjashtim të atyre kompetencave që ligji nuk ia njeh. Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë apo të tretëve për shkelje të ligjeve, për shkelje të statusit apo për faj të tij gjatë administrimit të shoqërisë.

Prishja e shoqërisë

Neni 13

Shoqëria pushon se ekzistuar në rastet e parashikuara nga neni 187 i ligjit nr.991, data 14/04/2008.

Likuidimi i shoqërisë:

Neni 14

Asambleja e ortakëve emëron likuidatorin, dhe shoqëria i jep fund veprimtarisë së saj në çastin e miratimit të këtij bilanci të likuidimit. Komisioni i likuidimit përbëhet nga një ose tre anëtarë. Pasuritë që janë vënë në dispozicion të shoqërisë me të drejtë shfrytëzimi, shiten në varësi të shkallës së konsumit të tyre. Mjetet financiare të shoqërisë të fituara si rezultat i veprimtarisë së shoqërisë e të filialeve të saj dhe fondeve financiare ndahen ndërmjet ortakëve në përpjestim me kuotat e vëna, pasi të jenë bërë pagesat për kreditorët.

Neni 15

Kur pushon veprimtaria e një filiali, për efekte të riorganizimit të tij, afatet e pushimit caktohen nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakut.



Likujdimi i filialeve bëhet njësoj si për shoqërinë. Mjetet financiare vihen në dispozicion të shoqërisë pasi t'u jenë bërë pagesat likujditorëve.

Dispozita të hollësishme mbi organizimin e kësaj shoqërie përcaktohen në statutin e saj.

ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË

GRETA DISHA

Greta Disha

